



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prinijena/Prodato Received/Delivered	14.07.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHUK	5254/2023		114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.748/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji** për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi Zyrat i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.748/2023 të datës 17.05.2023 të parashtruar nga ankuesja të cilën më autorizim e përfaqëson Hajzer Saliu, avokat nga Prishtina, kundër Vendimit KA.Nr.16/2023 të datës 18.04.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.07.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.748/2023 e datës 17.05.2023, e parashtruar nga ankuesja

**II. Mbetet në fuqi** Vendimi KA.Nr.16/2022 i datës 18.04.2023 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokuroria të Kosovës.

**A r s y e t i m**

Ankuesja (me tej vetëm ankuesja), e punësuar në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datë 17.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar nën shenjën A.nr.748/2023, kundër Vendimit KA.Nr.16/2023 të datës 18.04.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me pretendim ankimore së vendimi i ankimuar është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi si dhe në kundërshtim me udhëzimet e dhëna në Vendimin me numër A.nr.747/2022 të datës 13.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 26.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 01.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me



numër protokollit 4972/2023 të datës 30.06.2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje lidhur me ankesën e ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 4312/2023 të datës 17.05.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin në shenjë KA.Nr.16/2023 të datës 18.04.2023 të KZKAS-së; Ankesën me numër të protokollit 470 të datës 21.03.2023; Emalin e datës 24.02.2023 të drejtuar; Emalin e datës 29.12.2022 të drejtuar; Emalin e datës 28.12.2022 të datës drejtuar Kërkesën me numër të protokollit 2132/2022 të datës 14.12.2022 të parashtruar nga ankuesja lidhur me zbatimin e vendimit të KPMSHCK-së; Shkresën me numër të protokollit 2096/2022 të datës 08.12.2022 të U.D Drejtorit të Përgjohem të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Emalin e datës 12.12.2022 të B.Luzha drejtuar V.Neziri; Vendimin me numër KA.Nr.4.33/2022 të datës 07.11.2023; Vendimin me numër A.nr.747/2022 të datës 13.10.2022; Ankesën me numër të protokollit 5032/2022 të datës 30.08.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankese me numër të protokollit 748/2023 të datës 01.06.2023; Kërkesën me numër të protokollit 401/2021 të datës 18.03.2021 nga ankuesja; E-malin e datës 25.05.2022 nga ankuesja për; E-mailin e datës 08.12.2021 nga ankuesja për E-malin e datës 29.03.2022 nga për ankuesen; E-mailin e datës 18.03.2021 nga për V.Krasniqi; Përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 1215/2022 të datës 15.10.2022 nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore për ankuesen; Ankesën e datës 25.07.2022 të ankueses e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së; Vendimin me numër KA.Nr.26/2022 të datës 11.08.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; E-malin e datës 11.08.2022 nga i për ankuesen; Vendimin me numër KPK/Nr.459/2020 të datës 23.09.2020 të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për harmonizimin dhe nivelizimin e koeficienteve; Akt Emërimit me numër DBNJ/DSKPK-008/2019 të datës 02.09.2019; Shkresën me titull Aprovimin e titujve të punës-Këshilli Prokurorial i Kosovës me numër me referencën DASHC/MAP-04/240 e datës 28.10.2018; Shkresën e DASHC/MAP-04 (data nuk shihet) lidhur me procedimin në sistemin e pagave në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankese me numër të protokollit 5058/2022 të datës 01.09.2022; Përgjigjen në ankese me numër protokollit 5312/2022 të datës 12.09.2022; Konkursin e brendshëm (avancim në karrierë) me Referencën: Kodi: KPK/SKPK/POZ-007 i datës 10.07.2019 për pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës së Pagave; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit me numër DBNJ/DPSKPK/818/2020 i datës 01.10.2020; për pozitë Udhëheqës i Zyrës Ligjore; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit me numër DBNJ/DPSKPK/820/2021 i datës 15.03.2021 për pozitë Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Zyrës Ligjore, Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun dhe Udhëheqës i Zyrës së Pagave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të anësueses, SEPSE:

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhe së ankuesja është e punësuar në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe së e njëjta sipas Akt-it të Emërimit me numër DBNJ/DSKPK-008/2019 të datës 02.09.2019 është emëruar dhe vazhdon të ushtroj pozitën e punës *Udhëheqëse e Zyrës së Pagave*.

Ankuesja më datë 18.03.2021 i është drejtuar me shkrim U.d Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës më kërkesë për ngritje të koeficientit të pagës nga dhjetë (10) në trembëdhjetë (13), ndërsa më datë 29.03.2021 Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore ka njoftuar ankuesen së planifikimet buxhetore për këtë vit janë përfunduar, dhe se kërkesa për ngritje të koeficientit do të trajtohet në faza tjera. Ankuesja serish më datë 25.05.2022 i është drejtuar me kërkesë të njëjtë Udhëheqësit të Departamentit për Burime Njerëzore në SKPK-së, ndërsa në përgjigje të kërkesës së ankueses Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore më datë 18.07.2022 njofton ankuesen në emër të Drejtorit të Përgjithshëm



të SKPK-së se: *“jemi në proces të riorganizimit të brendshëm dhe sistematizimit të administratës në Sistemin Prokurorial të Kosovës dhe të gjitha kërkesat do të trajtohen gjatë këtij procesi”*

Ankuesja më datë 25.07.2022 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak të mos harmonizimit të koeficientit të pagë, ndërsa ky i fundit me Vendimin KA.Nr.26/2022 të datës 11.08.2022 ka hedhë poshtë si të pasafatshme ankesën e ankueses të datës 25.07.2022. Ankuesja brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar Vendimin KA.Nr.26/2022 të datës 11.08.2022, ndërsa, Këshilli me Vendimin A.nr.747/2022 të datës 13.10.2022, ka anuluar vendimin KA.Nr.26/2022 të datës 11.08.2022 të KZKA-së dhe çështjen e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit A.nr.747/2022 të datës 13.10.2022, Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me Vendimin A.nr.33/2023 të datës 07.11.2022 ka kthyer çështjen në shqyrtim pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës me detyrimin që kjo njësi të shqyrtoj kërkesën e ankueses për ngritje të koeficientit të pagës nga dhjetë (10) në trembëdhjetë (13). Në mungesë të përgjigjes nga Burimet Njerëzore lidhur me shqyrtimin e kërkesës së ankueses për harmonizim të koeficientit, ankuesja me datë 21.03.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesa të Këshillit Prokurorial të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit në zbatim të vendimit të KZKA-së me numër KA Nr.33/2022 të datës 2022, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit KA.Nr.16/2023 të datës 18.04.2023, ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar.

Ankuesja parashtron ankesë në Këshill duke kundërshtuar Vendimin KA.Nr.16/2023 të datës 18.04.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me pretendimin ankimor së vendimi i ankimuar është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi si dhe në kundërshtim me udhëzimet e dhëna në Vendimin me numër A.nr.747/2022 të datës 13.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Ankuesja shton se meqenëse tani ka hyr në fuqi Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ku me të njëjtin është rregulluar çështja e harmonizimit të koeficientit, ankuesja kërkon që Këshilli të obligoj KPK-në që ankuesit t'i bëjë kompensimin e diferencës së pagës nga koeficienti dhjetë (10) në koeficientin trembëdhjetë (13) duke filluar nga data 18.03.2021 deri me hyrjen në fuqi Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Me tej ankuesja thekson së ankueses i është mohuar e drejta për pagë të njëjtë për punë të njëjtë, për faktin së për punë të njëjtë koleget e saj në Zyrën Ligjore dhe Zyrën për Komunikim me Publikun kanë realizuar koeficient trembëdhjetë (13) të pagës, veprim ky që sipas ankues është në kundërshtim me Ligjin për Diskriminim pasi që ankuesja ka qenë e trajtuar në mënyrë më pak të favorshme së personat tjerë që kanë ushtruar pozita të kategorisë së njëjtë.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses Kolegji i Këshilli i'u refruar Aktgjykimit në rastin nr.KO203/19, të datës 9 korrik 2020 Nr. ref.:AGJ 1583/20 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 115 është përcaktuar se: *“ Megjithatë, duke pasur parasysh që Gjykata sapo ka konstatuar shkelje të Ligjit të kontestuar në raport me nëpunësit e KGJK-së dhe KPK-së por nuk ka anuluar zbatimin e Ligjit të kontestuar në raport me institucionet e tjera lidhur me të cilat nuk është kontestuar kushtetutshmëria e Ligjit të kontestuar, Kuvendi i Kosovës duhe t, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të kontestuar në harmoni me gjetjet e këtij Aktgjykimi, në mënyrë që të njeh të drejtën e KGJK-së dhe KPK-së për nxjerrjen dhe aplikimin e rregullave të tyre të brendshme, sa i përket, inter alia, çështjeve të strukturës organizative të funksionimit; klasifikimit të pozitave; kushteve të veçanta për rekrutim; orarit të punës; si dhe të drejtave dhe detyrimeve specifike të përcaktuara me Ligjin e kontestuar, ashtu si parashihet për nëpunësit e Kuvendit sipas nenit 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë], paragrafi 3 dhe 4, ku Kryesia e Kuvendit ka të drejtë të nxjerrë akte nënligjore për të rregulluar çështje të caktuara të nëpunësve të saj civilë.*

Kolegji për vendosje meritore të kësaj çështje juridiko-administrative mori parasysh edhe dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i zbatueshëm në kohën me të cilën është ndërlidhur periudha e kompensimit retroaktiv si në ankesë, përkatësisht Kolegji analizoj nenin 3 paragrafi 1 të këtij Ligji më të cilin përcaktohej se: : 1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të





kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil, ndërsa neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kontratës së punës,*

Rrjedhimisht referuar kuadrit ligjor si me lartë, Kolegji ka konstatuar së ankuesja me aktin e themelimit të marrëdhënies së punës (Akt Emërimi DBNJ/DSKPK-008/201) ka të përcaktuar koeficient dhjetë (10) të pagës, të cilin akt ankuesja e ka nënshkruar pa asnjë vërejtje dhe se e njëjta deri në hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ka realizuar koeficient dhjetë (10) të pagës, andaj, mbi këtë bazë dhe duke qenë së ankuesja me asnjë akt administrativ të organit të punësimit nuk i është njohur e drejta e nivelizimit të pagës nga koeficienti dhjetë (10) në koeficientin trembëdhjetë (13), Kolegji vlerëson së janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit mbi bazën e mohimit të së drejtës së nevillezimit të pagës.

Lidhur me pretendimin ankimore të ankueses së e njëjta është diskriminuar në raport me kolegët e saj pasi që Udhëheqësit e Zyrës Ligjore dhe Zyrës për Komunikim me Publikun janë paguar me koeficient trembëdhjetë (13) të pagës, Kolegji i Këshillit bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes vlerëson së pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk qëndron dhe si i tillë nuk ka mbështetje ligjore, ngase koeficienti i pagës përcaktohet në raport me përgjegjësinë e pozitës, nivelit të kompleksitetit të pozitës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë pozitë, dhe së pozita e Udhëheqësit të Zyrës Ligjore dhe Udhëheqësit të Zyrës për Komunikim me Publik nuk janë të njëjta me pozitën e Udhëheqësit të Zyrës për paga bazuar në kriteret si me sipër, andaj në rastin konkret nuk ekzistojnë rrethana të diskriminimit të ankueses, e që si të tilla do të përbenin veprim të organit të punësimit në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Për me të për, duke marr për bazë periudhën e kompensimit retroaktiv të kërkuar si në ankesë pra nga data 18.03.2021 deri me datë 05.02.2023 ( data e hyrjes në fuqi e Ligjit Nr.08/L196 për Pagat në Sektorin Publik), Kolegji ka gjetur se ankuesja kundër heshtjes së organit të punësimit të datës 18.03.2021 nuk kishte ushtruar mjet juridik të kundërshtimit deri me datë 25.07.2022 ( data e parashtrimit të ankesës në KZKA), duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, përkatësisht nenin 127 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ* andaj pretendimi ankimor për periudhën 18.03.2021 deri me datë 27.05.2022 konsiderohet si e palejueshem.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqësor për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda më numër A.nr.748/2023**

**Avdyll BEKTESHI**

*Procesmbajtëse*

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit me autorizim
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatën e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatën e Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së